

**Njoftim i përqendrimit ndërmjet Telemah BH d.o.o. Sarajevë Bosnje dhe Hercegovina dhe  
MISS.NET d.o.o. Bihaq, Bosnje dhe Hercegovinë**

**(lënda nr. 08-134/2022)**

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 05.10.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të pavarur nga shoqëria Telemah BH d.o.o. Sarajevë (Telemach BH d.o.o. Sarajevo), me seli në rrugën Xhemal Bijediq nr. 216, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, mbi shoqërinë MISS.NET d.o.o. Bihaq (MISS.NET d.o.o. Bihać), me seli në Bihaq, Saraevska 24, Bosnje dhe Hercegovinë.

**Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:**

**Telemah BH d.o.o** është një operator telekomunikacioni aktiv në Bosnje dhe Hercegovinë, që punon në grupin më të ngushtë të përbërë nga BC Partners - Junajted Grup (United Group), e cila ofron shërbime të telekomunikacionit dhe mediave në disa vende të rajonit. Fondet e BC janë ekskluzivisht investitorë financiarë, d.m.th. nuk janë të përfshirë në aktivitetet e përditshme të biznesit të kompanive ku ata investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtorëve.

BC Partners është e pranishme dhe e regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të mëposhtme të varura në mënyrë indirekte:

- Total TV SHPK Shkup, me seli në Bulevardin VMRO nr. 3, Qendër, Shkup, e cila merret me aktivitetet e telekomunikacionit satelitor,

-DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli në Orce Nikolov 68/3, Qendër, Shkup, e cila merret me aktivitete të marketingut, gjegjësisht me blerje dhe shitje të hapësirës reklamuese në media të shkruara dhe elektronike, dhe

UGI FIBER SHPKNJP Shkup, me seli në Bul. Partizanski Odredbi nr. 14, Qendër, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila merret me aktivitetet e telekomunikacionit satelitor.

MISS NET d.o.o. është një operator telekomunikacioni që është aktiv ekskluzivisht në Bosnje dhe Hercegovinë, në territorin e qyteteve Bihać, Cazin dhe Bosanska Krupa, në kantonin Unskosan. Kompania e synuar u ofron përdoruesve të saj shërbime të telefonisë fikse, akses në internet me brez të gjerë (kabllor dhe optik), si dhe shpërndarje të përmbajtjes mediatike.

MISS NET nuk është e pranishme dhe nuk gjeneron të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si tregje përkatëse, për qëllime të vlerësimit të përqendrimit, mund të përkufizohen: **tregu i telefonisë fikse, tregu i aksesit në internet me brez të gjerë fiks dhe) tregu i shpërndarjes së përmbajtjeve mediatike**, të gjitha në nivel të shitjes me pakicë.

*Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.*

*Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.*

07.10.2022

Shkup